

Nisma për pajisje elektronike “Mësimi digjital”

Pjesë nga broshura për personat me të drejtë kujdestarie (gusht 2021)

KA SHUMË ARSYE TË MIRA PËR SHKOLLËN DIGJITALE



pevels.com@Max Fischer

1 Digjitalja është sot një pjesë përbërëse bazë e botës së nxënësve dhe nxënëseve.

Aparaturat digjitale (p. sh. celularët ose tabletet) përdoren sot prej nxënësve dhe nxënëseve zakonisht çdo ditë, pavarësisht nga shkolla që ndjekin. Është e rëndësishme që fëmijët të mësojnë sistematikisht për t'i përdorur pajisjet ashtu siç duhet dhe atëhere kur duhet.

2 Nxënësit dhe nxënëset marrin pjesë në mënyrë aktive në organizimin e mësimin.

Përdorimi i pajisjeve digjitale krijon mundësi të reja në klasë. Kështu, nxënësit e nxënëset, duke përdorur mjete të thjeshta digjitale, mund të zhvillojnë vetë p.sh. teste të vogla. Këto mundësi mund të çojnë në një gatishmëri të shtuar për të marrë pjesë aktive në mësim. Materiale të krijuara vetë, siç janë videot, prezantimet ose simulimet, e kthejnë klasën digjitale në një hapësirë mësimore interaktive.

3 Pajisjet digjitale e rrisin motivacionin e nxënësve dhe nxënëseve.

Pjesëmarrja aktive shton dëshirën për të mësuar. Shembuj praktikë nga shkollat me përvojë tregojnë se shumë nxënës e nxënëse janë më të motivuar nga mësimi digjital. Kjo ndoshta nuk varet vetëm prej mundësive të reja për mësimdhënie dhe mësimnxënie, por edhe prej faktit se kështu mësimi mund të bëhet më i larmishëm dhe mund të përdoren formate të shumta mediatike vizuale dhe dëgjimore.

4 Mjetet digjitale mund t'u ndihmojnë mësuesve dhe mësueseve që ta kenë më mirë parasysht zhvillimin e lëndës mësimore.

Me mjetet moderne të komunikimit dhe përdorimin e aplikacioneve, mësimdhënësit mund të kujdesen për nxënësit e nxënëset duke u orientuar më mirë drejt nevojave të tyre dhe ta kenë më lehtë parasysht nivelin e dijeve të nxënësve dhe nxënëseve. Disa platforma mësimore lejojnë përveç kësaj që të përcaktohen detyra individuale, si dhe qëllimet e kryerjes së tyre, në mënyrë që të arrihet përparim më i mirë në mësim duke marrë parasysht gjendjen e secilit fëmijë.

5 Puna digjitale bën të mundur më shumë përfshirje.

Mësimi digjital ofron shumë mundësi për të trajtuar nevojat e veçanta. Për shembull, përmes opcioneve të ndryshme të ekranit të pajisjet digjitale, mund të ndimohen nxënësit dhe nxënëset që kanë vështirësi në pamje. Nxënësit dhe nxënëset me kufizime të lëvizshmërisë mund të kontribuojnë më mirë në klasë përmes ushtrimeve me dëgjim ose zë të mbështetura në mënyrë digjitale. Media digjitale mundëson një mësimdhënie moderne, e cila mund të përshtatet më mirë me nevojat e fëmijëve.

// Përdorimi i pajisjeve digjitale bën të mundur që nxënësit dhe nxënëset të përkrahen më mirë individualisht dhe në mënyrë të diferencuar. Ushtrimet mund të paraqiten në atë mënyrë që nivele të ndryshme vështirësish të mund të përdoren për të kërkuar dhe nxitur në mënyrë optimale. Për më tepër, mësuesit kanë më shumë kohë për t'u kujdesur individualisht për ata nxënës dhe nxënëse që kanë nevojë për shpjegime ose reagime shtesë.

HS-Prof. Mag. Dr. Sonja Gabriel, MA MA, Profesoreshë për Pedagogjinë dhe Didaktikën Mediatike, Kirchliche Pädagogische Hochschule Wien/Krems

SI MUND TA MBËSHTESNI FËMIJËN TUAJ KUR E PËRDOR PAJISJEN ELEKTRONIKE NË SHTËPI

Përmes nismës për pajisjet elektronike “Mësimi digjital”, fëmija juaj merr një pajisje të re digjitale që do ta përdorë në shkollë dhe për të mësuar në shtëpi. Kjo jo vetëm që duhet të jetë gjithmonë e ngarkuar, por duhet gjithashtu të jetë gati për përdorim me të gjithë aksesoret (kufje, kablo karikimi, etj.). Gjithashtu duhet të sigurohen **kopje të rregullta rezervë** të dokumenteve dhe **përditësimi i programeve**. Së bashku me Saferinternet.at, ne do t'ju japim këshilla se si mund ta përkrahni sa më mirë fëmijën tuaj.

//KUFIZONI KOHËN DHE TEMATIKËN

Së bashku me fëmijën tuaj mendoni se cilat programe mund të përdorë dhe për sa kohë, veç kësaj përshtatini këto marrëveshje herë pas here:
si.or.at/218, si.or.at/219

//SIGUROHUNI PËR AL- TERNATIVA DHE LËVIZJE

Si kundërpeshë ndaj mësimi digjital, e inkurajoni fëmijën tuaj në mënyrë konkrete që të ndër marrë edhe aktivitete të tjera, të tilla si lëvizje në ajër të pastër, aktivitete krijuese me materiale dhe ngjyra të ndryshme ose që të kalojë kohë me shokët dhe shoqet e tija.

//KUJDESUNI PËR MBROJTJEN E SFERËS PRIVATE

Në shumë raste në internet, njerëzve u kërkohet të japin informacione personale (emri, moshë, vendbanimi, etj.). Këto nuk janë gjithmonë të domosdoshme për përdorimin e aplikacioneve. Diskutoni me fëmijën tuaj se çfarë informacionesh lejohet të zbulojë për veten e tij dhe ku: si.or.at/leitfaden

////KUJDESUNI QË TË SHKONI MIRË ME TË TJERËT

Fëmijët duhet së pari ta mësojnë si të flasim dhe të sillemi me njerëzit e tjerë në internet. Ndihmoni fëmijën tuaj që të sillet me kujdes:
si.or.at/224

////PRAKTIKONI VLERËSIMIN E INFORMACIONEVE

Cilave informacione mund t'u besoni dhe cilave jo? Çfarë është reklamë, çfarë është informacion? Ushtroni me fëmijën tuaj si vihen në pyetje informacionet dhe si krahasohen disa burime me njëri-tjetrin: si.or.at/220

////SHMANGNI SHPEN- ZIMET E PADËSHIRUARA

Në shumë aplikacione dhe lojëra, mund të bëni blerje brenda aplikacionit me të holla të vërteta. Për ta parandaluar këtë, mund ta bllokoni këtë në pajisje dhe përveç kësaj përmes ofruesit të telefonit:
si.or.at/221

//////MERRENI SERIOZISHT FRIKËN E FËMIJËVE

Fëmijët hasin në mënyrë të përsëritur në internet në përmbajtje të diskutueshme. Përveç masave mbrojtëse teknike, janë të rëndësishme një bazë e mirë besimi dhe biseda me fëmijët:
si.or.at/222

//////SIGUROHUNI QË TË FLINI MJAFTUESHËM

Pajisjet digjitale nuk kanë vend në dhomën e gjumit. Edhe shokët e shoqet duhen lënë gjithashtu të qetë gjatë natës.

//////JU JENI NJË SHEMBULL

Se si prindërit japin një shembull për përdorimin e pajisjeve digjitale, cilat rregulla zbatohen në familje dhe si trajtohen problemet dhe vështirësitë, këto veprime janë vendimtare për sjelljen e fëmijëve. Mbani kontakte me fëmijët tuaj dhe tregoni interes për jetën e tyre digjitale: si.or.at/223


Das Internet sicher nutzen!

Broshura e plotë në gjermanisht: digitaleslernen.oead.at